



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1286 prot.

Tiranë, më 13. 09. 2021

Lënda: Rekomandim lidhur me marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për shpërndarjen në mënyrë të drejtë të nxënësve që rregjistrohen në klasën e I-rë.

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Rruga e Durrësit, Nr. 23,
TIRANË

Për dijeni: KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
TIRANË

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga “Aleksandër Moisiu”, përballë IKV,
TIRANË

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Lagjia 18, Rruga “Dhimitër Denasi”,
KORÇË

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ELBASAN

Lagjia “Dyli Haxhire”, Rruga “Janaq Kilica”, Nr. 21,
ELBASAN

LËVIZJES RINORE EGJIPTIANE-ROME

Lagjia “Qemal Stafa”, përballë ish poliklinikës dentare, kati 2,
ELBASAN

Të nderuar,

Në kuadër të:

- ✓ ushtrimit prej Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, të atributëve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për

Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;

- ✓ zbatimit të nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010, i cili parashikon:

“Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron këtë rekomandim, duke marrë shkas nga situata e krijuar në shkollat 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit dhe informacioni i vënë në dispozicion nga ana e Lëvizjes Rinore Egjiptiane-Rome, dhe që vijon aktualisht, si pasojë e:

- Mundësia e ofruar Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe prindërve për regjistrimin në klasën e parë, jashtë zonave të banimit, ka shkaktuar një shpërndarje jo të drejtë të nxënësve në klasën e parë në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Elbasanit, duke bërë që një pjesë e nxënësve të mbeten pa u regjistruar pranë zonës së tyre të banimit.
- Mundësia e ofruar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për regjistrimin on-line në institucionin arsimor publik, ka bërë që prindërit e nxënësve të komuniteteve rome dhe egjiptiane, që nuk i kanë patur mundësitë dhe aftësitë për të aplikuar nëpërmjet shërbimit e-albania, mund të vendosen në kushtet e vështirësisë për të regjistruar fëmijët në klasat e para.

Aktualisht, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ana e Lëvizjes Rinore Egjiptiane-Rome, në një pjesë të shkollave të qytetit të Elbasanit, kryesisht ato me infrastrukturë më të mirë, kanë plotësuar numrin e nxënësve të regjistruar në klasat e para, me fëmijë të maxhorancës, duke i lënë kështu fëmijëve që vijnë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian, mundësinë për t’u regjistruar në institucionet arsimore me infrastrukturë më të amortizuar.

Situata e mësipërme, sipas përfaqësuesve të Lëvizjes Rinore Egjiptiane-Rome, mund të sjellë krijimin e klasave vetëm me nxënës që i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane, duke i segreguar këta fëmijë dhe çuar në një të ardhme në braktisjen e shkollës.

Referuar rasteve të trajtuara më parë, në çështjet e shqyrtuara ku është konstatuar diskriminimi dhe segregimi i nxënësve të komunitetit rom dhe atij egjiptian, Komisioneri ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare, për shpërndarjen sa më të njëtrajtëshme të nxënësve romë dhe egjiptianë dhe krijimin e mundësive optimale dhe kushtet e duhura, për të arritur shmangien e situatave të segregimit.

Më konkretisht, në Rekomandimet e dhëna gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij “Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë”, Komisioneri ka kërkuar të mbahet në vëmendje që:

“... institucionet arsimore, duhet të ndjekin në vazhdimësi frekuentimin e shkollës nga ana e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve që i përkasin këtyre komuniteteve dhe atyre që nuk i përkasin, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian, për të parandaluar në këtë mënyrë, krijimin e zonave apo shkollave, të cilat frekuentohen vetëm nga fëmijë të komunitetit egjiptian. Një kujdes i posaçëm duhet të tregohet gjatë krijimit të klasave të para apo në rastet e ristrukturimit të klasave, për të shmangur veçimin apo segregimin e fëmijëve romë në klasa të caktuara, duke krijuar në këtë mënyrë klasa vetëm me fëmijë romë”.

Në vendimin Nr. 58, datë 08.05.2019, në të cilin Komisioneri ka shqyrtuar çështjen ex-officio që lidhet me segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në qytetin e Shkodrës dhe specifiki në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, ndër të tjera ka rekomanduar që: “...DAR Shkodër të zbatojë rigorozisht kriterin e vendosur në Dispozitat Normative, sipas të cilit nxënësit regjistrohen në shkollën që ndodhet në zonën e tyre të banimit. Duke implementuar këto dy dispozita, garantimin e transportit dhe regjistrimin e fëmijëve sipas kriterit të zonës së shkollës DAR Shkodër, mund të ndreqë situatën segreguese të krijuar në shkollën Liria dhe shkollën vartëse të saj”. Gjithashtu, në pikën 2 të vendimit të sipërcituar, Komisioneri ka urdhëruar që: “...të merren masat e nevojshme nga DAR Shkodër, për shmangien e situatës së segregimit, duke zbatuar Dispozitat Normative, në lidhje me zbatimin e kriterit të regjistrimit të nxënësve sipas zonës së shkollës.”

Në kushtet e mësipërme dhe nëse ndodh që në shkolla të caktuara të qytetit të Elbasanit, krijohen klasa të formuara nga fëmijë që vijnë vetëm nga komuniteti rom dhe egjiptian, institucionet përgjegjëse arsimore, janë në shkelje të Nenit 3, pika 16 e Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Veçimi është ajo formë diskriminimi, e cila ndodh në rastet kur një person ose grup personash ndahen nga të tjerët pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, dhe kjo ndarje bëhet për të paktën një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji”.

Përsa më sipër, referuar situatës së krijuar, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

REKOMANDON:

- **Marrjen e masave të menjëhershme, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan, për shpërndarjen në mënyrë të drejtë të nxënësve**

që rregjistrohen në klasën e I-rë duke respektuar kriterin e regjistrimit sipas vendbanimit përkatës, si dhe duke shmangur segregimin e nxënësve që vijnë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian në shkolla të veçuara.

- **Marrjen e masave të menjëhershme, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, për shpërndarjen në mënyrë të drejtë të nxënësve që rregjistrohen në klasën e I-rë duke respektuar kriterin e regjistrimit sipas vendbanimit përkatës.**

Lutemi marrjen e masave për zbatimin e këtij rekomandimi, në përmbushje të detyrimeve ligjore në fuqi, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit.

KOMISIONERI

Robert GAJDA